

Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës · Opština Djakovica · Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv/Bc. Inv. 0-410/04-4486 IV/2
Data/Datum/Date 28.06.2024

Gjakovë - Djakovica - Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 20.1, te Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi 632-24-621-2-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-002-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-4486, për shkak të një gabimi të pariparushëm në specifikacionin teknik i cili është bartur edhe në kontratë, më dt. 28.06.2024, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 20, paragrafi 20.1 i KPK përcakton se “Palët do t’i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.03.2024, me numër të prokurimit: : 632-24-621-2-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-002-221. dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-4486, me titull “: “Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme”Lot-23-Ri-Tender-Transporti i nxënësve në relacionin Molliq,Batushë dhe anasjelltas”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Hasan Alija B.I., Nivokaz, Gjakovë, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 01.07.2024.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne kërkesës e dt.18.06.2024, të menaxherit të kontratës, për shkak të një gabimi të pariparushëm në specifikacionin teknik i cili është bartur edhe në kontratë, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit

Për: ISA ZENUNI – Mehaxher i Kontratës

Nga: "HASAN ALIJA B.I"

Subjekti: KËRKESË PËR SHKËPUTJE TË KONTRATËS

KËRKESË

Unë Hasan Alija pronarë i kompanisë "HASAN ALIJA" B.I fitues e projektit me titull me:

Titulli: "Ri – Tender - Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme"
Lot 23 -Ri- Tender- Transporti i nxënësve në relacionin Molliq,Batushë dhe anasjelltas
Nr. i prokurimit: 632-24-621-2-2-1

Kontratë kjo e nënshkruar me dt: 22.03.2024 në mesë AK – Komuna Gjakovë dhe kompanisë "HASAN ALIJA" B.I, bëjë këtë kërkesë për shkëputje të kontratës sipas Kushtet e përgjishme paragrafi Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve paragrafi 10.2 ku thuhet: "Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe ofruesit të shërbimeve".

Pasi transporti që kemi bërë deri me tani kemi ardh në përfundim se duhet shkëputur kontrata është lidhur pa u bazuar ne orarin e mësimi, nese vazhdojmë me këtë kontratë dëmët do të jenë shumë mëdha për kompaninë.

Shpresoj që kjo Kërkesë të miratohet, dhe shkëputja e kontratës të bëhet prej datës 24.06.2024, pas përfundimit të procesit mësimore.

Gjakovë, me 18.06.2024

"HASAN ALIJA" B.I

Nënshkruar nga Hasan Alija
Pozita: Drejtor



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SHFMU,, JAHË SALIHU"
Nr.prot: Zyrt.
DATA: 18.06.2024
MOLLIQ

-Kryetarit të KK Gjakovë z.Ardian Gjini
-Zyres së Prokuorimit në Gjakovë

Lënda:
**KËRKESË PËR SHKËPUTJE MIQËSORE TË KONTRATËS PËR
TRANSPORTIN E NXËNËSVE BATUSHË-MOLLIQ**

Unë Isa Zenuni menaxher i kontrates për transportin e nxënësve Batushë -Molliq kam pranuar Kërkesë nga firma „Hasan Alija B.I” për shkëputje miqësore të Kontrates nga data 24.06.2024. Firmë kjo që ka Kontarta për bartjen e këtyre nxënësve. Duke u bazuar në nenin 10 te kushtet e përgjithshme të Kontrates paragrafi 10.2 mendojmë se firma ka të drejtë në shkëputje

të kontrates pasi që kjo kontrata është lidhur gabimisht pa u bazuar në orarin mësimor të shkollës, me një bartje të nxënësve në mëngjes nga Batusha deri në shkollë dhe bartja e nxënësve nga shkolla në Batushë mbas përfundimit të mësimit, e që kjo është gabim sepse duhen dy bartje duke u bazuar në orarin e shkollës.

Ne dëshmojmë se Hasan Alija si drejtor i Operatorit ekonomik “Hasan Alija B.I”, gjatë vitit shkollor 2023/24 ka bartë nxënësit nga Fshati Botushë në Molliq dhe anasjelltas çdo ditë pune nga fillimi i kontrates, e është paguar vetëm për një bartje.

Këtë e ka bërë në këtë mënyrë: ka sjellë nxënësit në mëngjes në ora 7:40 nga kl-3 deri në kl-9, në ora 9:25 i ka sjellë nxënësit e klasës parafillore, kl-I- dhe kl-II-, në ora 11:50 i ka marrë nxënësit e ciklit të ulët që i kan pas kater orë, si dhe në ora 12:40 i ka marrë të gjithë nxënësit kur edhe ka përfunduar mësimi komplet. Është paguar vetëm për një ardhje –vajtje.

Si shkollë ju bashkangjesim orarin e shkollës dhe kërkojmë nga zyra e prokuorimit t'i shkëputet Kontrata firmës në fjalë dhe t'i hapet rruga rregullimit të bartjes në bazë të orarit të shkollës sonë.

Me respekt!



Drejtori:

[Handwritten signature]

- Isa Zenuni-Menaxher i Kontrates

-Arten Hamza-Kryetari i KDSH - *[Handwritten signature]*

-Agim Sejda-Mësimdhënës - *[Handwritten signature]*

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SHFMU,,JAHË SALIHU"
NR. 05/2024
DATA: 22.03.2024
MOLLIQ



DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT NË GJAKOVË

Lënda:

NJOFTIM PËR ORARIN E MËSIMIT NË SHFMU,,JAHË SALIHU" NË MOLLIQ

Njoftojmë DKA në Gjakovë se orari i mësimit në shkollën tonë fillon me sa vijon:

- Klasa III, IV, V, VI, VII, VIII, IX fillojnë mësimin në ora 8.00
- Klasa Parafillore, -I- dhe -II-të fillojnë mësimin në ora 9.35

-Nxënësit që transportohen nga fshatrat Batushë dhe Brovinë, duhet të barten dy here nga fshati në shkollë dhe anasjelltas, sepse mësimi për tri paralele fillon në ora 9.35 dhe njëherit nxënësit e klasëve që kanë 4 ose 5 orë mësim, duhet të transportohen nga shkolla në shtëpi pas përfundimit të mësimit.

Me respekt!



Venera Shtaloja

From: Faton Gutaj
Sent: Thursday, June 20, 2024 2:26 PM
To: Venera Shtaloja; Besim Haxhija
Subject: FW: Kërkesë për shkëputje Kontrate-Isa Zenuni-Menaxher i Kontrates për transport të nxënësve Batushë-Molliq
Attachments: Për ISA ZENUNI - Mehaxher i Kontratës.pdf; KËRKESA PËR SHKËPUTJE TE KONTRATES.pdf; ORARI MËSIMOR I SHKOLLËS J.SALIHU.pdf

Me respekt
Faton Gutaj
Tel : 038 200 44 041
Menaxher i Prokurimit



...
Respectfully
Faton Gutaj
Phone: 038 200 44 041
Procurement Manager
Gjakova Municipality

From: isa zenuni <isazenuni@live.com>
Sent: Tuesday, June 18, 2024 5:01 PM
To: Ardian.Gjini@rks-gov.nrt
Cc: Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Eranda Baçi <eranda.baci@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për shkëputje Kontrate-Isa Zenuni-Menaxher i Kontrates për transport të nxënësve Batushë-Molliq

Caution! This message was sent from outside your organization.

Përshëndetje Kryetar i KK Gjakovë z. Ardian Gjini
z.Faton Gutaj, znj. Eranda Baçi!

Shpresoj se jeni mië dhe ju urojmë punë të mbarë.
Unë Isa Zenuni-menaxher i kontrates së transportit të nxënësve për firmen „Hasan Alija B.I”, e cila bartë nxenesit e fshatit Batushë deri në shkollën e Molliqit, me 18.06.2024 kam pranuar kërkesë nga kjo firmë për shkëputje miqësore të kontrates për transportin e nxënësve.
Dokumentacionin me kërkesën e firmës, kërkesën time si menaxher dhe orarin e shkollës po ju bashkojmë në emajl.

Me respekt!

Drejtori i shkollës: Isa Zenuni- Menaxher i kontrates

Molliq: 18.06.2024